



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 9
Prishtinë, më 24 maj 2011, në orën 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Muhamet Mustafa, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, Bedri Hamza dhe Kosum Aliu – Ministria e Financave.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatore - KIPRED (staf mbështetës), Artan Venhari dhe Albert Krasniqi dhe Arta Demolli – praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 18.05.2011,
3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor për Funkcionimin e Sistemit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, për vitin 2010,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 18. 05. 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 18. 05. 2011.

3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor për Funksionimin e Sistemit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, për vitin 2010,

Kryesuesi – Në materialin e prezantuar shihet qartë progresi që është bërë në ngritjen e kapaciteteve në sferën e legjislacionit, megjithatë kjo mbetet sfida, pastaj është bërë progres në trajnimin e auditorëve të njësive dhe në këtë kontekst ka certifikime të personave që flet për përgatitje më të lartë. Komisioni gjatë punës megjithatë vëren disa parregullsi që mund të jenë individuale. Nga 63 njësi të auditimit 2 nuk kanë dhënë raporte, por në tabelë shihet që ka me shumë Komuna që nuk e kanë këtë njësi dhe ne duhet të hulumtojmë mekanizma se si të vihet në funksion, apo të trajtohet edhe buxheti i tyre për performancën, për gjendjen atje.

Bedri Hamza – ministër – Në programin e punës së prioriteteve të Qeverisë në vazhdimësi kërkohet nga të gjithë shpenzuesit e mjeteve buxhetore që të ndërtojnë sisteme efikase të kontrollit menaxhimit të riskut, parasë publike dhe të performancës operationale për tu siguruar që paratë në secilin subjekt përdoren si duhet dhe në harmoni me ligjin. Hartimi i raportit është rezultat i raporteve të marrura nga njësitë e auditimit të brendshëm nëpër OB. Raporti prezanton të arriturat dhe sfidat gjatë viti 2010, në nivelin qendrorë dhe lokal. Si të arritura gjatë vitit 2010 janë: hartimi i bazës ligjore për auditimin e brendshëm, aftësimi dhe trajnimi i auditorëve të brendshëm në lëmenjtë kyç profesional, rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitutional në këtë drejtim. Ka rritje të numrit të auditimeve të brendshme nga 59 në 64 njësi, rritje të numrit të komiteteve të auditimit nga 31 në 36, rritje të numrit të auditorëve të brendshëm nga 97 në 111. Janë kryer 364 auditime të brendshme, dhe me qëllim të përmirësimit të sistemit të kontrollit janë dhënë 1987 rekomandime. Prej tyre 53.5% janë implemetuar, 28.23% janë në proces të implementimit dhe 18.42% nuk janë implemetuar. Për të adresuar çështjet e paraqitura ne rekomandojmë që të ndërmerren disa veprime gjatë vitit 2011. Menaxhmenti i subjektit të sektorit publik të plotësoj njësitë e auditimit, me staf të nevojshëm sipas planeve për auditim dhe standardeve profesionale. Auditorët e brendshëm të përkrahen nga menaxhmenti duke u siguruar kushte për punës, pavarësi, dhe mos kufizim të kontratave të punës, pjesëmarrje në trajnime të organizuara. Subjektet e sektorit publik të cilat ende nuk i kanë krijuar komitete të auditimit ti krijojnë ato në bazë të Udhëzimit. Një përkushtim më i lartë i menaxhmentit transparencë, llogaridhënie dhe kompetencë në kontrollin e brendshëm.

Lars Lage OLOFSSON - auditor i përgjithshëm – ZAP është duke finalizuar sezonin e auditimit duke audituar OB individuale dhe kur të finalizohet kjo ZAP i përgjithëson konkluzionet në nivelin e përgjithshëm. Aktualisht nuk kam pikëpamje të përgjithshme sa i përket funksionimit të sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, pasi që nuk e ka lexuar raportin.

Armend Zemaj – Tha se ka qenë kryesues i grupit punues për monitorimin e zbatimit të Ligjit për auditim të brendshëm, në vitin 2009, mbi bazën e të cilit edhe është ndryshuar ai ligj. Personalisht gëzohet për të arriturat e auditimit e cila si aktivitet ndikon drejtpërdrejtë në përmirësimin e menaxhimit të punës në OB. Raporti është i kompletuar dhe si të tillë e përkrahë. Pyeti: në raport nuk ka analizë apo vërejtje rreth ligjit, sa NJQHA e ka pa të zbatueshëm Ligjin për auditim të brendshëm në tri fushat kryesore e sidomos në pavarësinë e auditorëve, formimin e Komiteteve të Auditimit, pasi që akoma ka OB të cilat nuk kanë formuar këto Komitete si dhe implementimi i rekomandimeve. Implementimi i rekomandimeve paraqitet problem edhe nga ZAP-i. Pavarësia e auditorit – sa ka vërejtur NJQHA se auditorët janë shndërruar partner të menaxherëve të OB.

Ramiz Lladrovci – Raporti është i paraqitur shumë mirë, inkurajoj ministrinë që të vazhdoj në implementimin e rekomandimeve. Përkrah raportin.

Muhamet Mustafa- Shprehë kënaqësinë për proceset e auditimit të brendshëm, pasi që niveli i kënaqshëm në auditim reflekton në efikasitetin e shpenzimit të fondeve publike. Shihet një punë e organizuar në ngritjen e kapaciteteve. Kërkoj arsye se pse nuk është arritur numri i planifikuar i

auditimeve dhe ku duhet përqendruar është krijimi i komiteteve të auditimit sepse raportet auditimit nuk duhet të shkoj vetëm në dorën e një individi. Pra esenciale është puna e komiteteve të auditimit. Komitetet janë ato që marrin përgjegjësinë për implementimin e rekomandimeve.

Murselj Haljilji – Raporti prezanton të dhëna të cilat flasin për progresin në këtë lëmi dhe për këtë përgëzoj ministrinë. Në numrin e auditorëve të brendshëm, nuk ka të dhëna e cila flet për përfaqësimin e komuniteteve. Kjo pyetjeje i është bërë edhe ZAP-it dhe informatat kanë qenë alarmante sa i përket kësaj, kjo ka të bëjë me zhvillimin e demokracisë në Kosovë.

Valbona Dibra – Ministria e Financave gjatë vitit 2010, ka prezantuar një zhvillim të madh. Auditimi i brendshëm ka rol të madh në arritjen e objektivave. Trajnimi i vazhdueshëm profesional është në vazhdimësi si dhe krijimi i komiteteve të auditimit. Krijimi i Komiteteve të Auditimit për secilën organizatë kërkon shumë staf, ngarkohet buxheti dhe për këtë i pëlqen ideja që QKUK dhe Ministria e Shëndetësisë kanë një Komitet të Auditimit. Pra OB që kanë një lëmi të njëjtë të kenë një komitë të auditimit.

Afrim Hoti – Nuk ka shumë vërejtje në raport, ndonëse flitet për rritjen e numrit të auditorëve. Konsideroj se ka nevojë për shtimin e numrit të auditorëve. Kryetari aktual i Komunës së Rahovecit e ka gjetur komunën në gjendje të mjeruar dhe gati 2/3 e buxhetit ka qenë borxh dhe keqpërdorime. Për këto keqpërdorime askush nuk është përgjigjur. Lidhur me këtë duhet bërë hulumtime prandaj duhet shtuar numrin e auditorëve në këtë Komunë.

Kryesuesi- Disa institucione nuk e kanë dorëzuar strategjinë – a ka NJQHA mekanizëm për ti detyruar OB për të prezantuar strategjitë. Krijimi i Komiteteve është një çështje e mirë, nuk u pajtua që QKUK dhe MSH të kenë të njëjtin komitet të auditimit, sepse njëri është staf civil e tjetri jo dhe kjo ka ndodhë për të imponuar varshmërinë e tyre. Pra për të mirën e QKUK-së është mirë të ketë komitetin e veçantë të auditimit.

Bedri Hamza – Të gjithë do të kontribuojnë në drejtimin pavarësisë së auditorëve. Raportet e auditorëve të brendshëm do të shërbejnë edhe si bazë e mirë për punë e ZAP-it. Si ministër do të mbështesë NJQHA për të formuar të gjitha komitetet e auditimit. Çështja e rekomandimeve, është me shumë rëndësi - shuma e parasë që ka të bëjë me ato rekomandime. Edhe struktura nacionale do të merret në konsideratë më rastin e krijimit të njësive dhe të komiteteve të auditimit. Ministria do të mbështetë të gjitha kërkesat e OB-ve që kanë të bëjnë me numrin auditorëve dhe të njësive të auditimit.

Kosum Aliu – NJQHA – Implementimi i Ligjit për Auditimin e Brendshëm, gjatë punës është vërejtur se prap ka mangësi, për këtë do të bëhen amendamente në ndërkohë. Pavarësia e auditorëve të brendshëm – ligji garanton një gjë të tillë. Po ashtu ligji parasheh themelimin e Komiteteve të Auditimit, të cilat ndihmojnë që OB të performojnë më mirë dhe të zhvillojnë idetë e tyre. Auditimi i brendshëm në Kosovës është diçka e re dhe kemi për qëllim që të ngrisim kapacitetet e cilësisë në këtë drejtim. Në ligjin e parë ka qenë e paraparë që qdo OB ta ketë komitetin e auditimit dhe numri i OB ka qenë shumë i madh, kjo ka qenë e pamundur për shkak të kostos. Mirëpo në ligjinbe e ri është paraparë që për disa OB të vogla të krijohet një komitet i auditimit i cili do të jep shërbime për disa OB. P.sh në kuadër të Kuvendit të Kosovës janë shumë OB të cilat nuk i plotësojnë kriteret për të krijuar komitete të auditimit. NJQHA ka rekomanduar që këto OB të kenë një njësi të auditimit. Aktualisht na mungon numri i auditorëve. Nuk është profesionale e as e arritshme që një OB të ketë një auditorë. Për komitetet e auditimit është nxjerr Udhëzimi që përcakton kriteret se cilat OB duhet të kenë Komitet të Auditimit. Plan i nuk është realizuar për shkak të numrit të vogël të auditorëve dhe për shkak se të gjithë auditorët e brendshëm kanë qenë të përfshirë në procesin e trajnimeve. 54 prej tyre kanë qenë të përfshirë në proces të certifikimit. Deri në korrik do të kemi një numër të konsiderueshëm të auditorëve të certifikuar. Kjo me qëllimin që ne të bëhemi pronar të programit për certifikimin e auditorëve.

Lars Lage OLOFSSON - auditor i përgjithshëm – Nëse e shohim sistemin e auditimit të brendshëm apo sistemin e tërë të menaxhimit publik financiar kualiteti i auditorëve të brendshëm, të jashtëm dhe financiar është shumë e rëndësishme të shohim sa larg kemi arritur. Në fq 5 thuhet çka duhet të jetë auditimi i brendshëm dhe mendoj që do të ishte mirë për parlamentin që në këtë raport përveç indikatorëve sasior të ketë edhe një analizë më të detajuar se deri ku kemi arritur në zhvillimin e auditorëve të brendshëm në lidhje me atë se çka duhet të përmbush auditimi i brendshëm. Ne duhet të sigurojmë një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm profesional në sektorin publik duke siguruar që më kalimin e kohës kemi auditor me kompetenca në menaxhimin e financave. Përveç progresit që kemi bërë kemi sfida për menaxhimin financiar dhe kështu që duhet të analizojmë më detajisht se ku jemi për të ndermarrë hapat tjetër. Dëshiroj të shoh më shumë rreth kësaj vitin tjetër. Ishte i kënaqur që në raport sheh ndryshimi në mes të institucioneve të pavarura që japin llogari para kuvendit dhe ato para qeverisë. Duhet të gjejmë mekanizma për funksionimin e këtyre institucioneve edhe pse të vogla. Kjo është çështje e rëndësishme për kuvendin që të siguroj një sistem të mirë të llogaridhënjes për institucionet e pavarura. Cilësia e informacionit të pasqyrave financiare dhe zbatueshmëria e rekomandimeve nuk janë në nivel të kënaqshëm dhe ne duhet të gjejmë një mekanizma më të mirë për këtë në mes menaxherëve. Dëshiroj që në vitin tjetër ky raport të ketë më shume analizë. Në ZAP

Ramiz Lladrovci – Tha se z Lage nuk mund të komentoj raportin meqenëse u deklarua qysh në fillim se nuk e ka analizuar. Këtë mund ta bëjë pasi që të bëjë një analizë vjetore të auditimit të brendshëm dhe të raportoj para këtij komisioni.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri ka vendosur që Kuvendit t'i

REKOMANDOJ

- **Të Miratohet Raporti Vjetor për Funksionimin e Sistemit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, për vitin 2010.**
- **Arsyetimin e Rekomandimit e paraqet, deputeti Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.**

4. Të ndryshme

Kryesuesi njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me planin e veprimit të Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina për zbatimin e rekomandimeve të ZAP-it.

Mbledhja përfundoi në orën 14:40.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu